



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, datë 23.12.2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e rregullores “Për kërkesat e posaçme që ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove duhet të përmbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim”.
(Vendim nr. 128, datë 23.12.2024).
2. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Alushi Group” sh.p.k., me administrator z. Klevis Alushi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Maxnet”.
(Vendim nr. 129, datë 23.12.2024).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 23 dhjetor 2024